



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1044/2 Prot.

Durrës, më 4.4.2025

VENDIM

Nr. 34, datë 4.4, 2025

PËR

"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 64, DATË 18.12.2024 "PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E AKTIVITETEVE KËRKIMORE SHKENCORE, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; Udhëzimin e përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; në Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së; në Kodin e Etikës në Kërkimin shkencor të UAMD-së; në vendimin e Senatit nr.70, datë 19.10.2021; Vendimin e Senatit nr.27, datë 11.05.2023; Urdhrin e Rektorit nr.539, datë 20.11.2024; Relacionin e Grupit të punës nr.2591 prot., datë 16.12.2024; në shkresën 1002 prot., datë 28.03.2025 dhe në relacionin e Drejtorisë Juridike me Nr. 1002/1 prot., datë 02.04.2025, në mbledhjen e datës 04.04.2025 Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 64, datë 18.12.2024 "Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore Shkencore, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", përkatësisht në nenin 15, pika 3 gërma c, sipas materiali bashkëlidhur.
2. Ky vendim i bashkëlidhet si pjesë e pandashme Vendimit nr.64, datë 18.12.2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
REKTORATI

Dr. juridike
Përgatitje relacion drejtuar
Senatit Akademik

[Signature]

Nr. 1002 Prot.

Durrës, më 28.03 / 2025

LËNDA: Për një ndryshim në Rregulloren e Aktiviteteve Kërkimore-Shkencore në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës

Drejtuar: Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

Kryetar i Senatit Akademik

I nderuar Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi,

Me Vendimin Nr. 64, datë 18.12.2024, Senati Akademik ka miratuar Rregulloren e Aktiviteteve Kërkimore-Shkencore në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti në rritjen e cilësisë së publikimeve shkencore dhe rritjen e impaktit të kërkimit shkencor në UAMD, lutemi Senatit Akademik të shqyrtojë dhe miratojë propozimin e grupit të punës për një ndryshim në Nenin 15 të kësaj Rregullore, si më poshtë:

Teksti ekzistues:

Neni 15

Botime në Revista Shkencore të Indeksuar

Pika 3, gërma (c)

"Të ketë cituar të paktën 3 (tre) artikuj të botuar në revista shkencore, autorë të të cilëve të jenë personel akademik me kohë të plotë në UAMD."

Teksti i propozuar:

Neni 15

Botime në Revista Shkencore të Indeksuar

Pika 3, gërma (c)

"Të ketë cituar të paktën 3 (tre) artikuj të botuar në revista shkencore, të indeksuar nga Scopus ose Clarivate Analytics (Journal Citation Report me Impact Factor), autorë të të cilëve të jenë personel akademik me kohë të plotë në UAMD."

Ky ndryshim synon të rrisë vlerësimin akademik dhe ndërkombëtarizimin e botimeve të stafit akademik të universitetit tonë, duke u fokusuar në revistat shkencore të indeksuara në platformat më të njohura ndërkombëtare.

Në pritje të vendimit, ju falenderojmë paraprakisht.

Me respekt,

Prof. Dr. Azeta Tartaraj

Kryetare e Grupit të Punës

